



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA - MUNICIPALITY

HANI I ELEZIT

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA - OPSTINA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



DATA:	28/06/2022	Nr. i Prot. 11 6764	Nr. i Faq. 2	Data 22.08.2022
PËR:	z. Mehmet Ballazhi, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit			
NGA:	z. Abduraman Bushi, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural			
LËNDA:	Raporti për periudhën Janar - Qershor 2022			



Në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022 kemi pasur disa aktivitete, duke filluar prej muajit Janar deri në muajin Qershor 2022, e ata janë:

- Kemi pasur konfiskime të drunjve me një sasi prej 61.8 m³ të gjitha janë shkarkuar në depo të komunës dhe janë bërë fletëparaqitje për në gjykatë.
- Nga rojtarët e pyjeve janë dorëzuar 136 fletëparaqitje, 122 fletëparaqitje kundërvajtje dhe 14 fletëparaqitje penale me një masë drusore prej 115.92m³ dhe në dëmin e llogaritur prej 16127.11 €.

Paraqesim në formë tabelore krahasimin e fletëparaqitjeve të vitit të kaluar (2021) me periudhën e njëjtë të vitit 2022

Viti	2021	2022
Fletëparaqitje penale	5	14
Fletëparaqitje kundërvajtje	73	122
Gjithsej	78	136

- **Pyjet private:** Në pyjet private kemi pranuar 17 **kërkesa** për prerje të drunjve në teritorin e komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 të gjitha kërkesat kanë qenë të dorëzuara në afat deri më 31 Mars, ku është e paraparë me ligj.
- **Vendimet Gjygsore:** Nga gjykata kemi pranuar 72 vendime, prej tyre 67 vendime pozitive, 4 vendime parashkrim dhe 1 vendim qortim.
- **Të hyrat** nga APK-ja për gjashtëmuorin e parë të vitit 2022 kanë qenë 257 euro
- **Kërkesa** për ndërrim destinimin e pronave private kanë qenë 2 kërkesa,
- **Thirrje publike** për furnizim të lirë të qytetarëve me drunj për ngrohje nga pyjet publike nga data 21/06/2022 deri më 05/07/2022.
- **Subvencionet** janë kryer vetëm për subvencione direkt nga Ministria ku kanë aplikuar 92 fermer (101 fermer në vitin 2021).

- Kemi formuar 4 komisione :

Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për prerje të druve në pyjet private.

Komisionin për regjistrimin e dëmeve pyjore.

Komisionin për dëmet e shkaktuara nga ariu.

Komisionin për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

-Kam dorëzu në MBPZHR-në projektin për ndërtimin dhe rehabilitimin e kanalit të ujitjes „Lloka” më 10/06/2022, me L=253m dhe vlerë 14,719.50 euro.

Me respekt nga

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Abduraman Bushi